



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:121144  
Datë: 25.05.2022  
Numri i dokumentit: 03054261

C.nr.874/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Spahija, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëseve H.L. nga fshati S., komuna D., Y.D. dhe I.D. që të dyja nga Gj., të cilat sipas autorizimit i përfaqëson i autorizuari Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, rruga “Fehmi Agani” Hy – 25/4, kundër të paditurës D.K.A., të cilinë e përfaqëson përfaqësuesi Dardan Bakija, me autorizim, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, vlera e kontestit 2,659.10 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të paditëseve dhe të përfaqësuesit të paditurës, me datë mori 16 maj 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses H.L., nga komuna D., dhe DETYROHET e paditura D.K.A., që paditëses H.L., nga komuna Deçanit, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore 14.06.2018 – 12.05.2022, për 671 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 1,409.10 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga paraqitja e padisë datë 14.06.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses Y.D. nga Gj., dhe DETYROHET e paditura D.K.A., që paditëses Y.D. nga Gj., në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore 01.02.2021 – 12.05.2022, për 291 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 582,00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga paraqitja e padisë datë 14.06.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses I.D. nga Gj., ashtu që DETYROHET e paditura D.K.A., që paditëses I.D. nga Gj., në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore 01.06.2020 – 12.05.2022, për 334 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 668,00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga paraqitja e padisë datë 14.06.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura D.K.A., që paditëses H.L., Y.D., dhe I.D., të i'u kompensojë shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme prej 498,00 euro, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë me datë 14.06.2021 përmes të autorizuarit të lartpërmendur të tyre, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, kjo pasi që të njëjtët janë punëtorë të arsimit në Institucionin Parashkollorë "G." në Gjakovë. I autorizuari i paditëseve në fjalën e dhënë ne seancën e shqyrtimit kryesorë ka deklaruar se mbetem në tersi pranë padisë dhe kërkesës padisë, fillimisht duke bere precizimin e kërkesës padisë në aspektin objektiv, për paditësen H.L., sa i përket kompensimit të udhëtimit për periudha dt.14.06.2018 e deri me dt.12.05.2022 , ku gjatë kësaj periudhe ka realizuar 671 ditë pune, dhe për çdo ditë pune ka udhëtuar nga vendbanimi i saj D. për ne vendin punimin e saj për në Gj., nga çka rrjedh se në emër të shpenzimit të udhëtimit i takon shuma prej 1,409.10 € (kjo pasi që e njëjta ka paguar 3,00 € në ditë dhe 70% i kësaj bilete i bie shuma prej 2.10 €), për paditësen Y.D., sa i përket kompensimit të shujtave nga periudha 01.02.2021 e deri me dt.12.05.2022, e cila gjatë kësaj periudhe ka realizuar 291 ditë pune, për të cilin në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit i takon shuma prej 582,00€, si dhe për paditësen I.D., sa i përket kompensimit të shujtave nga periudha 01.06.2020 e deri me dt.12.05.2022, ku gjatë kësaj periudhe e njëjta ka realizuar 334 ditë pune, për të cilin në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit i takon shuma prej 668.00€. Andaj, i njëjti edhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar që padia dhe kërkesëpadia e precizuar e paditësve të aprovohet si e bazuar, dhe të detyrohet e paditura që paditëses së parë në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit të ia paguaj shumën prej 1,409.10 euro, paditëses së dytë në emër të kompensimit të ushqimit të ia paguaj shumën prej 582,00 euro si dhe paditëses së tretë në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit shumën prej 668,00 euro, të gjitha këto me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Shpenzimet procedurale i kërkojmë dhe atë: taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 20,00 €, për përpilimin e padisë prej 208,00 € dhe për përfaqësim në një seancë gjyqësore nga 270,00, apo në shumën e përgjithshme 498.00 €.

I autorizuari i të paditurës deklaroi se kontrata e kolektive e arsimit në Kosovë e nënshkruar në mes MASHT dhe SBASHK-ut me dt. 22.01.2021, në nenin 47 të saj, ka shfuqizuar Kontratën kolektive të dt.18.04.2017, ashtu edhe sipas nenit 35 par. 5 dhe par 7 të kësaj kontrate si dhe lidhur me këtë dhe dispozitave kalimtare të nenit 450 par.1 nuk është bërë kurrfarë ndihmese në planifikimin e buxhetit për realizimin e kërkesave lidhur me zbatimin e dispozitave të nenit 35 par.5 dhe par.7 deri sa të krijohen mundësit financiare në Buxhetin e R. Kosovës, por jo më vonë se viti 2023. Andaj edhe sipas Qarkores buxhetore 2022/01 i dt. 14.05.2021, të lëshuar nga z. H.M. Ministër Financave në grandin specifik të arsimit para universitar nuk është e paraparë pagesa e udhëtimit të mëshim dhënëseve dhe kompensimit të ushqimit në punë, si dhe lidhur me

këtë kërkesë thirremi në parashkrim të paraparë sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, ashtu që kërkesa e paditësve është parashkruar dhe atë për periudhën 01.05.2015 deri me datën 17.04.2017, Ndërsa sa i përket zmadhimit të kërkesë padisë për paditëset deri me datën 12.05.2022 të njëjtën nuk e kundërshtoj. Andaj i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesë padia e paditëseve të refuzohet si pa bazuar me ligj.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontratë pune për paditësen H.L., e lëshuar nga D.K.A., në version të fotokopjuar me nr. të kontratës 43/33/19, Vërtetimi i lëshuar nga Institucioni Parashkollorë “G.”, me Nr.prot.43/2/2022, të datës 12.05.2022 për paditësen H.L., Certifikata e vendbanimit me nr. B10314629, e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Deçan, për paditësen H.L., Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit, Kontrata e punës për paditësen Y.D., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në version të fotokopjuar me nr. të kontratës 09/21, Vërtetimi i lëshuar nga Institucioni Parashkollorë “G.”, me Nr.prot.42/2/2022, të datës 12.05.2022 për paditësen Y.D., Kontrata e punës për paditësen I.D., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në version të fotokopjuar me nr. të kontratës 43/37/19, Vërtetimi i lëshuar nga Institucioni Parashkollorë “G.”, me Nr.prot.42/3/2022, të datës 12.05.2022 për paditësen I.D.

Gjykata pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimi veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e precizuar e paditëseve, është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontratë pune për paditësen H.L., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në version të fotokopjuar me nr. të kontratës 43/33/19, është vërtetuar fakti se e njëjta është në marrëdhënie pune në Institucionin Parashkollorë : shkolla “G.” në Gj., pozita: motër edukatore dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2015 – e përhershme. Vërtetim i lëshuar nga Institucionin Parashkollorë “G.” në Gj., me Nr. prot.43/2/22 të datës 12.05.2022, provon rrethanën se këtu paditësja punon në institucionin e lartpërmendur që 40 vite, e njëjta nga data 14.06.2018 deri me datë 12.05.2022, ka të mbajtura 671 ditë pune. Certifikata e vendbanimit me nr. B10314629, e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Deçan, për paditësen H.L. provon faktin se paditësja jeton në fshatin S., K. Deçan, si dhe Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit, provon faktin se çmimi i biletës nga Gj. – D., në një drejtim kushton 1.50 euro.

Nga Kontrata e punës për paditësen Y.D. e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, në version të fotokopjuar me nr. të kontratës 09/21, është vërtetuar fakti se e njëjta është në marrëdhënie pune në Institucionin Parashkollorë: “G.” në Gjakovë, Vërtetim i lëshuar nga Institucionin Parashkollorë “G.” në Gjakovë, me Nr. prot.42/2/22 të datës 12.05.2022, provon rrethanën se këtu paditësja punon në institucionin e lartpërmendur që dy vite, e njëjta nga data 01.02.02021 deri me datë 12.05.2022, ka të mbajtura 291 ditë pune (referuar kompensimit për shujtë ditore).

Nga Kontrata e punës për paditësen I.D. e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, në version të fotokopjuar me nr. të kontratës 43/37/19, është vërtetuar fakti se e njëjta është në marrëdhënie pune në Institucionin Parashkollorë: “G.” në Gjakovë. Vërtetim i lëshuar nga Institucionin Parashkollorë “G.” në Gjakovë, me Nr. prot.42/3/22 të datës 12.05.2022, provon rrethanën se këtu paditësja punon në institucionin e lartpërmendur që 44 vite, e njëjta nga data 01.06.2020 deri me datë 12.05.2022, ka të mbajtura 334 ditë pune (referuar kompensimit për shujtë ditore).

Me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, në mënyrë identike parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.*

Gjykata nga administrimi i provave të cilave prova dhe ja fali besimin e plot, gjeti se paditëset janë në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Institucionin Parashkollorë: “G.” në Gjakovë. Paditësja Y.D., për periudhën kohore nga data 01.02.2021 – 12.05.2022, ka vijuar 291 ditë të pranisë në punë, fakt ky i vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga po ky institucion me Nr. prot.42/2/22 të datës 12.05.2022, ndërsa paditësja I.D., për periudhën kohore nga data 01.06.2020 – 12.05.2022 ka vijuar 334 ditë të pune, provuar sipas vërtetimit të lëshuar nga po ky institucion me Nr. prot.42/3/22 të datës 12.05.2022. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësve nuk i’au ka paguar shpenzimet e ushqimit e parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që, e ditët e kaluara në punë të paditësve, i ka shumëzuar me 2, duke i’au njohur shumat si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në nenin 35 parg. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017 dhe të asaj të datës 22.01.2021, në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.* Nga provat e administruara, gjykata konstatoi se paditësja H.L., vendbanimin e ka në fshatin S., komuna e D., provuar sipas certifikatës së vendbanimit të lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Deçan, e datës 29.03.2021, dhe njëjta për çdo ditë punë ka udhëtuar nga vendbanimi i saj, komuna e D. për në vend punimin e saj në Gjakovë. Për periudhën kohore, nga data 14.06.2018 - 12.05.2022 paditësja ka vijuar 971 ditë të pranisë në punë, kjo e provuar sipas vërtetimi të lëshuar nga Institucionin Parashkollorë “G.” në Gjakovë, me Nr. prot.43/2/22 të datës 12.05.2022. Lartësinë e kërkesëpadisë lidhur me këtë kriter të kompensimit, gjykata e vërtetojë në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit në Gjakovë, ku lartësia e çmimit të biletës për relacionin Deçani- Gjakovë është 3,00 euro në ditë për të dy drejtimet. Andaj, duke pasur përsyshë që e paditura, paditësës H.L., nuk i’au ka paguar shpenzimet e udhëtimit e parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësës është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të

ushqimit bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që, ditët e kaluara në punë të paditëses, i ka shumëzuar me 70% të çmimit të biletës së trafikut urban në relacionet ku e njëjta ka udhëtuar duke i'au njohur shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysht edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratë Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në *“Gazetën Zyrtare”* të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëseve, të ia paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, pretendimet e të paditurës se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësja në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe ajo e viti 2021 kurse mungesa e buxhetit të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sa i përket pretendimit të paditurës për parashkrimin e kërkesës për periudhën kohore nga data 01.01.2015 e deri me datën 17.04.2017, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e tij, pasi që i autorizuari i paditësit ka bërë tërheqjen e kërkesëpadisë së paditësve lidhur me këtë periudhë kohore.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, tutje paragrafi 2 i këtij neni parashihet se *“Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e udhëtimit që ka pasur ndaj këtu paditëses, gjykata vlerëson së përpos kërkesës kryesore, të njëjtës i takon edhe kamata e gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditëset për udhëheqjen e kësaj procedurë kanë pasur shpenzime të domosdoshme, siç më poshtë vijojnë: në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi, shuma prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë, shumën prej 208,00 euro, si dhe për pjesëmarrje të autorizuarit të tyre në një seanca gjyqësore, shumën prej 270,00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 498.00 euro.

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.874/2021, me 16 maj 2022

Gj y q t a r e,  
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.